

Shoqeria Konçënsinare Z.M.A Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 dhjetor 2020

	Shënimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,294,968	53,218
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	5	1,689,646	13,050
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	131,847,786	55,053,908
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	8,140,413	4,347,383
Totali i aktiveve afatshkurtra		142,972,813	59,467,559
Aktivet afatgjata			
Aktive financiare	8	683,511,760	281,082,737
Aktive afatgjata materiale	9	48,640	60,800
Totali i aktiveve afatgjata		683,560,400	281,143,537
Totali i aktiveve		826,533,213	340,611,096
DETÝRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	98,723,484	-
Llogari të pagueshme tregtare	11	564,445	310,927
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	277,686,909	270,446,359
Detyrime tatimore	13	376,351	474,417
Totali i detyrimeve afatshkurtra		377,351,189	271,231,703
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	10	242,193,400	66,969,991
Totali i detyrimeve afatgjata		242,193,400	66,969,991
Totali i detyrimeve		619,544,589	338,201,694
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		201,200,000	100,000
Rezerva të tjera		10,000	-
Fitime/(Humbje) të mbartura		2,299,402	(25,000)
Fitimi i ushtrimit		3,479,222	2,334,402
Totali i kapitalit	14	206,988,624	2,409,402
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		826,533,213	340,611,096

Pasqyra e pozicionit finanziar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Te ardhura te perllogaritura sipas SKK 13	15	402,429,023	281,082,737
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	16	1,409,501	(58)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(386,830,628)	(277,602,869)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	17	(383,570,306)	(276,166,474)
2) Të tjera shpenzime	18	(3,260,322)	(1,436,395)
Shpenzime të personelit	19	(2,467,657)	(537,913)
1) Paga dhe shpërblime		(2,111,282)	(460,937)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(356,375)	(76,976)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(12,160)	(15,200)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	20	(56,085)	(14,816)
Shpenzime financiare	21	(10,368,435)	(162,911)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(10,368,435)	(162,911)
Fitimi/humbja para tatimit		4,103,559	2,748,970
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(624,337)	(414,568)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(624,337)	(414,568)
Fitimi/humbja e vittit		3,479,222	2,334,402
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		3,479,222	2,334,402

Pasqyra e performancës duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vittit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2019	100,000	-	-	(25,000)	75,000
Transferim ne fitimet e pashpërndara	-	-	(25,000)	25,000	-
Fitimi / Humbja e vittit	-	-	-	2,334,402	2,334,402
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	100,000	-	(25,000)	2,334,402	2,409,402
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	201,100,000	-	-	-	201,100,000
Transferim ne rezerva	-	10,000	(10,000)	-	-
Transferim ne fitimet e pashpërndara	-	-	2,334,402	(2,334,402)	-
Fitimi / Humbja e vittit	-	-	-	3,479,222	3,479,222
Pozicioni më 31 dhjetor 2020	201,200,000	10,000	2,299,402	3,479,222	206,988,624

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u nënshkruan si më poshtë më 31 mars 2021 nga:

Endrit Brune
Administrator

SHPK
Z. A. 1290261
V. 18/12/2020
ALBANIA
11/2021

Endrit Brune
Ekonomiste

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit	3,479,222	2,334,402	
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	12,160	15,200	
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
Rënje/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(480,899,497)	(336,134,198)	
Rënje/(rritje) në shpenzime të shtyra	(3,793,030)	(3,336,950)	
Rritje/(rënje) në detyrimet e pagueshme	7,396,002	269,389,366	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(473,805,143)	(67,732,180)	
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	201,100,000	-	
Pagesa e huave	273,946,893	66,969,991	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	475,046,893	66,969,991	
Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	53,218	815,407	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	1,294,968	53,218

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqeria Konçesionare “Z.M.A” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 22 Maj 2018 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” me NIPT L81729026T.

Shoqeria Konçesionare “Z.M.A” sh.p.k është një shoqëri e themeluar në përbushje të kushteve e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Konçesionit për “Permirsimin e Infrastruktures Arsimore në Bashkinë e Tiranës” nënshkruar më 17 Tetor 2018 ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinise si Autoriteti Kontraktor si dhe Bashkimi i operatorve ekonomike “ZENIT&CO & AGI KONS & MET ENGINEERING” si Konçesionari.

Kjo Marrëveshje është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.353, datë 19 Prill 2017 publikuar në Fletoren Zyrtare.

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është “projektimi, financimi, ndertimi, mobilimi, mirembajtja, mbikqyrja dhe kolaudimi i pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1, që percaktohen në Kontratën e Konçesionit me Bashkinë Tiranë (“Projekti”).

Periudha e konçesionit fillon në Datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon në datën e përfundimit të tij (“Periudha e Konçesionit”). Në varësi të përfundimit të parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me kushtet e saj, Periudha e Konçesionit do të jetë 7 (shtatë) vjet nga data efektive (faza e operimit). Data e hyrjes në fuqi eshte 17.10.2018.

Pas perfundimit te kohezgjatjes se konçesionit ne perputhje me kontraten e konçesionit, Konçesionari ne fund te periudhes se konçesionit ben dorezimin e objekteve arsimore dhe te gjithave pasurive te tjera te lidhura projektin tek Autoriteti Kontraktues.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lek, i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

- ZENIT&CO – 0.15 %
- AGI KONS – 86.95 %
- MET-ENGINEERING – 12.9%

Administrator i shoqërisë është Z. Endrit Bruci.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. “Unaza e Re”, godinë banimi dhe shërbimi, njësia II O4, Tiranë. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 4 punonjës (2019: 3).

2. Bazat e përgatitjes së paqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së paqyrave financiare (vazhdim)

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësimet dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimet dhe supozimet që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimet dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.4.1 Gjykime mbi efektet pandemise në parimin e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i llogarive te arkëtueshme, inventari dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsyë vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.4.2 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimet bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së paqyrave financiare (vazhdim)

2.4.3 Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkeseve të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

2.6 Trajtimi kontabel i koncensionit

Shoqëria ka gjykyar që trajtimi i kontrates se koncensionit do te kryehet në përputhje me kërkessat e standardit kombëtar kontabel 13 Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare pasi shoqeria ka objekt te kushteve te kontrates projektimin, financimin, ndertimin dhe mobilimin e pese objekteve arsimore ne Zonen Tirane si edhe mirembajtjen dhe mbikqyrjen e ketyre objekteve per një periudhe 7 vjecare pas venies ne operim. Per kete sherbim shoqeria do te paguhem me shuma fiksë nga koncesiondhenesi gjate fazes se mirembajtjes. Pra shoqeria ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë mjete monetare ne perputhje me sherbimet e kryera nga koncesiondhenesi. Shoqeria I njeh te ardhurat ne perputhje me volumin e punimeve dhe sherbimeve te kryera dhe nga ana tjeter njeh një aktiv finanziar per te arketuar nga koncesiondhenesi.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/ Lek	100.84	108.64

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë nijhen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përveç së përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten së përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet finansiare c'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigionit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjetave monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Toka	Nuk amortizohet
Ndërtesa, makineritë dhe paisje	5%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%
Të tjera	20%

Metoda e amortizimit,jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5 Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

3.6 Provisjonet

Një provisjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provisjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provisjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provisionet rimerren.

3.7 Trajtimi kontabël per marreveshjen e koncesionit

Shoqeria ka aplikuar SKK 13 per njojen e kontrates së koncessionit.

Sherbimet e ndërtimi ose të përmirësimit janë njojur në përputhje me kërkesat e SKK 13 me vlerën e tyre të drejtë. Nga ana tjeter shoqëria ka njojur një aktiv finanziar pasi ajo plotëson kushtet e paragrafit 25 pika të SKK 13 sipas të cilit:

Operatori duhet të njohe një aktiv finanziar në masën që ai ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër finanziar nga ose në drejtimin e koncesiondhënësit për ndërtimin e shërbimeve. Operatori duhet të masë aktivin finanziar me vlerën e drejtë. Më tej, ai duhet të ndjekë SKK 3 Instrumentet Financiare.

3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare, të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vtitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vtitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 eshte 15%, (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare për vitin që mbyll më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë	1,271,605	29,855
Mjete monetare në arkë	23,363	23,363
	1,294,968	53,218

5. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Met Engeneering	-	12,900
Zenit &CO shpk	-	150
Agikons	1,689,646	-
	1,689,646	13,050

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH e arkëtueshme	131,847,786	55,053,908
	<u>131,847,786</u>	<u>55,053,908</u>

7. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të shtyra	7,880,580	4,347,383
Parapagime	259,833	-
	<u>8,140,413</u>	<u>4,347,383</u>

8. Aktive Financiare

Aktivet Financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aktive financiare (Kontrata Konçesionare)	683,511,760	281,082,737
	<u>683,511,760</u>	<u>281,082,737</u>

Shoqeria ka njojur aktivin financiar ne perputhje me vleren e tregut te sherbimeve te kryera sic tregohet ne shenimin numer 3.6.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Të tjera	Totali
Kosto		
Gjendja më 1 janar 2019	76,000	76,000
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	76,000	76,000
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	76,000	76,000
Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2019	-	-
Amortizimi i vitit	15,200	15,200
Gjendja më 31 dhjetor 2019	15,200	15,200
Amortizimi i vitit	12,160	12,160
Gjendja më 31 dhjetor 2020	27,360	27,360
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 dhjetor 2019	60,800	60,800
Gjendja më 31 dhjetor 2020	48,640	48,640

10. Hua

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Raiffaisen Bank pjesa afatgjatë	242,193,400	66,969,991
Raiffaisen Bank pjesa afatshkurtër	98,723,484	-
	340,916,884	66,969,991

Shoqëria ka nenshkruar një kontratë huaje me Raiffeisen Bank ne daten 18 prill 2019 për një vlerë totale prej 8.27 milion euro e cila do te disbursohet ne disa keste. Afati i shlyrjes se kredise eshte 42 muaj nga data e disbursimit të kestit. Norma vjetore e interesit është Tribor 12 mujor +1.5% por jo me pak se 5%.

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare	564,445	310,927
	564,445	310,927

12. Llogari të pagueshme ndaj paleve te lidhura

Llogari të pagueshme ndaj paleve te lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Agikons shpk	269,896,109	266,725,509
Total llogari te pagueshme tregtare	269,896,109	266,725,509
Agikons shpk	7,790,800	3,720,850
Total llogari te pagueshme te tjera	7,790,800	3,720,850
	277,686,909	270,446,359

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	11,544	11,042
Detyrime per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	52,549	48,807
Tatim fitimi	312,258	414,568
	376,351	474,417

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 (Vlerat janë në Lek)

14. Kapitali

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 201,200,000 Lek.

Përbërja e kapitalit të Shoqërisë, në fund të vitit 2020 dhe 2019, paraqitet si më poshtë:

Ortaku	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Kuota %	Vlera	Kuota %	Vlera
ZENIT&CO	0.15	301,800	0.15	150
AGI KONS	86.95	174,943,400	86.95	86,950
MET ENGINEERING	12.9	25,954,800	12.9	12,900
Totali	100	201,200,000	100	100,000

Fitimi i ushtrimit të Shoqërisë për vitin 2020 është në vlerën 3,479,222 Lek (2019: 2,334,402 Lek).

Rezervat e tjera të shoqërisë për vitin 2020 janë në vlerën 10,000 Lek.

Fitimet e mbartur të shoqërisë për vitin 2020 janë në vlerën 2,299,402 Lek. Në 2019 shoqëria rezulton me humbje të mbartur në vlerën 25,000 Lek.

15. Të ardhura të përllogaritura sipas SKK 13

Të ardhura të përllogaritura sipas SKK 13 për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura të përllogaritura sipas SKK 13	402,429,023	281,082,737
	402,429,023	281,082,737

Shoqëria ka përllogaritur të ardhura mbi vlerën e investimit të kryer në shumën 402,429,023 Lek. Kjo shumë, përfaqëson vlerën e investimit të kryer i cili do ti shlyhet kompanisë koncesionare në vitet e ardhshme. Për këtë shumë shoqëria ka njohur një aktiv finanziar sic tregohet në shënimin 8 të pasqyrave financiare. Kjo shumë e përllogaritur e të ardhurave, e cila po njihet në këtë vit ushtrimor dhe do të paguhet nëpërmjet arkëtimit në vitet në vijim.

Rakordimi me FDP

31 dhjetor 2020

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në

Qarkullim i tatushëm 1,408,555

Fitim nga kembimet valutore 962

Te ardhurat te perllogaritur sipas SKK 13 402,429,023

Shuma e qarkullimit e korrektuar 403,838,540

Sipas Kontabilitetit 403,838,540

Diferenca -

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

16. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Humbje nga kembimet valutore	(16)	(58)
Fitim nga kembimet valutore	962	-
Te ardhura te tjera	1,408,555	-
	1,409,501	(58)

17. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera

Kostoja e materialeve të para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Punime ndërtimi	382,800,458	267,976,876
Studime e Projekteve	-	6,445,590
Mbikqyerje	400,000	200,000
Të tjera	369,848	1,544,008
	383,570,306	276,166,474

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

18. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit pë vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje Energji,avull,ujë karburant	1,024,565	122,358
Shpenzime qeraje	78,000	78,000
Shpenzime te tjera	414,180	326,433
Shpenzime administrative noteraiale	10,800	679,000
Kostua e materialeve te shitura	125,095	-
Prime sigurimi	84,433	97,121
Komisione bankare	1,102,333	66,483
Taksa të ndryshme	74,500	67,000
Konsulencë ekonomike juridike	346,416	-
	3,260,322	1,436,395

Shërbimet e marra nga auditues ligjor për vitin 2020 janë 346,416 Lek.

19. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime për paga	2,111,282	460,937
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	356,375	76,976
	2,467,657	537,913

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 4. (2019: 3).

Struktura e kompanise me 31 dhjetor 2020 eshte si me poshte :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Pozicioni	1
Administrator	1
Arkitekt	1
Staf	2
	4

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

20. Shpenzime te tjera te shfrytezimit

Shpenzime e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Gjoba të ndryshme	56,085	14,816
	56,085	14,816

21. Shpenzime financiare

Shpenzime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime për interesa	10,368,435	162,911
	10,368,435	162,911

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatushme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitimi para tatimit		
Total shpenzime të panjohura	4,103,559	2,748,970
Shpenzime udhëtimi	58,685	14,816
Penalitete, gjoba e dëmshpérblime	-	14,816
Shpenzime të tjera	56,085	-
	2,600	
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	4,162,244	2,763,786
 Tatim fitimi @15%	 624,337	 414,568
	3,479,222	2,334,402

Shoqeria Konçensinare Z.M.A Sh.p.k

Shënimë shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

23. Palët e lidhura

Një përbledhje e balancave me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Agikons shpk	1,689,646	277,686,909	-	270,446,359
Met Engeneering	-	-	12,900	-
Zenit &CO shpk	-	-	150	-
	1,689,646	277,686,909	13,050	270,446,359

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Agikons shpk	1,689,648	459,438,552	-	274,816,407
Zenit &CO shpk	-	301,800	-	-
	1,689,648	459,740,352	-	274,816,407

25. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve te shoqërise, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financier të Shoqërise ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

Kontrata koncesionit

Shoqeria eshte e angazhuar ne kontraten e koncesionit për "Permirsimin e Infrastrukturës Arsimore ne Bashkine e Tiranes" nenshkruar me 17 Tetor 2018 ndermjet Bashkise Tirane dhe Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise si Autoriteti Kontraktor si dhe Bashkimi i operatorve ekonomike "ZENIT&CO & AGI KONS & MET ENGINEERING" si Koncessionari.

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas dates se bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.